

REPubLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
GJKATA SUPREME E KOSOVËS Vrhovni Sud KOSOVA
G.J.A-Su.A 101 / 2019
Dt: 13 / 03 / 2019
PRISHTINË - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat , më datë 11.03.2019, me shumicë votash miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka rregulluar parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve, për situata që ndërlidhen me lartësinë e dënimit të shqiptuar me burgim si dhe dënimit me gjobë. Në rast se për të njëjtën veprë penale shqiptohet dënim me burgim dhe dënim me gjobë siç është parapa në KPK, afati i parashkrimit duhet të caktohet sipas dënimit me burgim si dënim kryesor.

Arsyetim

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me parashtrësën Agj.I.nr.351/18 datë 30.08.2018 nga Gjykata Supreme e Kosovës, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik në lidhje me llogaritjen e afatit të parashkrimit në rastin e shqiptimit të dënimit me burg dhe me gjobë si dënim i veçantë për veprën e njëjtë penale, duke i ofruar gjykatës edhe rast konkret dhe interpretimin nga ana QK Dubravë, të cilët kanë dilema rreth llogaritjes së parashkrimit të situatave tjera të ngjashme.

Duke analizuar në kontekst të përgjithshëm të parashkrimit të ndjekjes penale, dispozita e nenit 106 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar në mënyrë shprehimore se afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë. Në anën tjetër komentari i KPK i vitit 2014 (autor Ismet Salihu faqja 329 dhe 330) shpjegon po citoj“ nëse për një vepër penale janë paraparë shumë dënime në mënyrë kumulative, p.sh. dënimi me burgim dhe dënim me gjobë, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit me burg si dënim kryesor”, ndërsa duke komentuar dispozitën e nenit 108 të Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve (faqja 336) autori në komentuar përkufizon po citoj, “ Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit varet prej lartësisë së dënimit të shqiptuar. Kohëzgjatje e afateve të parashkrimit është përcaktuar sipas dënimit kryesor. “

Andaj edhe te parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve në rast se për një vepër penale është shqiptuar dënim burgimi dhe dënimi me gjobë pasi që në disa raste në KPK parashihet obligimi i gjykatës që të shqiptoj të dy dënimet, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit caktohet nga kohëzgjatja e dënimit kryesor dhe nuk mundë të ndahet dënimi me gjobë si dënim i veçantë kuptohet se në rast se i dënuari e paguan gjobën i njëjti e përmbush pjesën e detyrimit që ia ka caktuar gjykata, por në rast se nuk e paguan atëherë ai dënim nëse zëvendësohet në dënim burgimi kohëzgjatja e afateve të parashkrimit përcaktohet sipas dënimit kryesor.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 11.03.2019)